



identiTek

Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë dhe Drejtimit të
Brendshëm

2025

HYRJE

identiTek Sh.a. është themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 80, datë 14.02.2023 *“Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”* në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”* si një shoqëri anonime me 2 nivele. Shoqëria është regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT M31613043O, më datë 15.03.2023.

Kapitali i nënshkruar dhe plotësisht i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 është 20,000,000 lekë. Shoqëria zotërohet nga Shoqëritë Ministria e Brendshme me pjesëmarrje 100%.

ORGANIZIMI

Organet drejtuese të shoqërisë “IdentiTek” janë:

Asambleja e Përgjithshme (Aksionari), i cili është organi më i lartë vendimmarrës në shoqëri.

Këshilli Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme:

- Kledia Ngjela- Anëtar
- Eni Diçi - Anëtar
- Armand Skapi - Anëtar
- Mimoza Selmani - Anëtar
- Alba Halili - Anëtar

AKTIVITETI

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është:

- Objekti i Shoqërisë është kryerja e shërbimit kundrejt pagesës, të prodhimit dhe shpërndarjes së:
 - a) letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike (të zakonshme, të shërbimit dhe diplomatike);
 - b) dokumentit biometrik (leje qëndrimi për të huajt për çdo motiv me përjashtim të lejes provizore dhe humanitare);
 - c) letërnjoftimit elektronik për personat që kanë përfituar statusin e refugjatit dhe mbrojtje plotësuese;
 - d) dokumentit të udhëtimit për personat që kanë përfituar statusin e refugjatit dhe mbrojtje plotësuese;
 - e) çdo dokumenti tjetër biometrik që lëshon Ministria e Brendshme dhe institucionet në varësi të saj brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore si dhe çdo shërbim tjetër në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj.
- Shoqëria aksionare ofron shërbime të tjera shtesë të lejuara nga legjislacioni në fuqi për subjekte publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit dhe fushën e veprimtarisë së saj.

- Shoqëria mund të kryejë aktivitete/veprimtari për studimin, projektimin, këshillimin e konsultimin për aktivitetet e përcaktuara në shkronjat a – d, të pikës 1.
- Shoqëria brenda kufijve që parashikon legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të reja, si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- Për përmbushjen e veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Aktiviteti i shoqërisë kryhet në bazë të Ligjit Nr. 8668 datë 23.10.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit” dhe Ligjit Nr. 8952, datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronike të shtetasve shqiptarë”.

Më datë 01.08.2023, Identitek sh.a. nisi zyrtarisht operimin e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë, shitjen e kuponëve nëpërmjet Postës Shqiptare, pranimin e aplikimeve për dokumente biometrike, prodhimin dhe shpërndarjen e tyre.

PRODUKTET DHE CMIMI

Çmimi i produkteve (kuponave) është i njëjtë me ato të zbatuara deri më tani. Më konkretisht tarifat në fuqi janë:

Kategoria	Emërtimi	Vlera e kuponit	Monedha	Vlera në lekë		
				Vlera pa TVSH	TVSH	Total
Letërnjoftim	Standard	1,500	LEK	1,500	0	1,500
	Për ambasadë (ITA, GRC)	12	EUR	1,354	0	1,354
	Për aplikim të shpejtë	3,00	LEK	3,000	0	3,000
	Për Ambasadën në SHBA	18	USD	1,879	0	1,879
	Për ambasadat në vendet EU	16	EUR	1,805	0	1,805
	Për Ambasadën në Mbretërinë e Bashkuar	13	GBP	1,673	0	1,673
	Për ambasadën në vendet Aziatike	18	USD	1,879	0	1,879
	Për Ambasadën në Zvicër	18	CHF	2,060	0	2,060
	Për Ambasadën në Danimarkë	-	DKK	-	-	-
Pasaporta	Standard	7,500	LEK	6,250	1,250	7,500
	Për aplikim të shpejtë	18,00	LEK	15,000	3,000	18,000
	Për ambasadë (ITA, GRC)	130	EUR	12,222	2,444	14,666
	Për Ambasadën në SHBA	240	USD	20,883	4,177	25,059
	Për ambasadat në vendet EU	170	EUR	15,982	3,196	19,178
	Për Ambasadën në Mbretërinë e Bashkuar	130	GBP	13,942	2,788	16,730
	Për ambasadën në vendet Aziatike	240	USD	20,883	4,177	25,059
	Për Ambasadën në Zvicër	240	CHF	19,460	3,892	23,352

	Për Ambasadën në Danimarkë	-	DKK	-	-	-
Leje qëndrimi	Për leje qëndrimi	5,700	LEK	4750	950	5,700
Letërnj. refugj. dok. udhëtimi	Standard ID	1,500	LEK	1,500	0	1,500
	Standard për pasaporta	7,500	LEK	6,250	1,250	7,500

Këto çmime janë të specifikuara në udhëzimin nr. 54 datë 23.03.2025 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët të ministrit të brendshëm dhe ministrit të financave dhe ekonomisë nr.100, datë 20.7.2023, “Për përcaktimin e tarifave për pajisjen e shtetasve shqiptarë dhe të huaj me dokumente biometrike”.

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E SHOQËRISË

Prodhimi dhe shpërndarja e dokumenteve biometrike të sigurtë

Siguria e dokumenteve biometrike paraqet një prioritet kryesor, duke pasuar një qëllim të qartë dhe të rëndësishëm: garantimin e integritetit të dokumenteve. Fokus të veçantë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit tonë në këtë fushë, duke ruajtur një standard të lartë dhe duke parandaluar çdo lloj veprimi të mundshëm të falsifikimit, vjedhje dhe tjetërsimit të identitetit.

Përditësimi i infrastrukturës dhe teknologjisë dhe projektit Identiteti Dixhital për Shtetasit Shqiptarë

Teknologjia e prodhimit - Përditësimi i teknologjisë së prodhimit të dokumenteve biometrike përfshin investimin në pajisjet dhe mjete të nevojshme për prodhimin e dokumenteve biometrike. Ndryshimi i pajisjeve të vjetra me pajisje bashkohore dhe të avancuara teknologjike për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e prodhimit.

Përmirësimi i efikasitetit dhe kapacitetit

Përmirësimi i infrastrukturës dhe teknologjisë do të përfshijë rritjen e kapacitetit të prodhimit dhe rritjen e efikasitetit të proceseve. Kjo do të lejojë shoqërinë të zhvilloj produkte në mënyrë horizontale duke bërë të mundur futjen e produkteve të reja si psh “Fast ID”/Letërnjoftimi i Përsheptuar etj.

Cilësia e shërbimit dhe kujdesi ndaj klientëve (qytetarëve)

Cilësia e shërbimit dhe kujdesi ndaj klientëve paraqesin një prioritet të lartë në strukturën dhe operacionet tona, me qëllim të sigurimit të një shërbimi të kujdesshëm dhe efikas për aplikuesit për dokumente biometrike. Shoqëria ka planifikuar investime që ndikojnë direct në përmirësimin e cilësisë së shërbimit për të siguruar një eksperiencë pozitive për klientët tanë.

Objektivat kryesore janë përqëndruar në rritjen e nivelit të kujdesit të klientëve dhe përmbushjen e kërkesave të aplikuesve në një kohë më të shpejtë, duke e ngritur kështu cilësinë e shërbimit. Për të arritur këto objektivat, implementojmë standarde të larta cilësore, trajnimin e stafit për të trajtuar me profesionalizëm çdo klient, si dhe përdorimin e teknologjisë së fundit për të përmirësuar efikasitetin dhe shpejtësinë e procesit.

PROJEKTET AFATMESËM

Përditësimi i infrastrukturës dhe teknologjisë është prioriteti kryesor i Shoqërisë për vitet 2026 – 2027 në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e prodhimit të dokumentave biometrike si domosdoshmeri dhe detyrim ligjor i Ministrisë së Brendshme ndaj qytetarëve. Teknologjia e trashëguar ka një nivel të lartë amortizimi dhe ka përmbushur ciklin jetësor dhe është afër fundit të saj.

Më 01.08.2023 Identitek sh.a nisi zyrtarisht operimin në gjithë Shqipërinë, shitjen e kuponëve, pranimin e aplikimeve për dokumente biometrike dhe prodhimin e dokumenteve biometrike. Gjatë kësaj periudhe është analizuar, kryer kontrole dhe audituar sistemet e marra në dorëzim për të konstatuar gjëndjen e infrastrukturës dhe teknologjisë aktuale në përdorim.

Sistemi aktual prezanton risk të lartë për shkak të pajisjeve:

- të cilat kanë përfunduar jetën teknike (EOL);
- që nuk mbështeten më nga prodhuesit;
- të cilat përbëjnë dobësi kritike për sigurinë kombëtare.

Gjatë procesit të auditimit të sistemeve të informacionit gjatë fazës së inventarizimit nga auditues i jashtëm IT, i kontraktuar nga Identitek, është evidentuar një gamë e problemeve kritike në infrastrukturë (Raporti të Auditit të Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike Nr. 318 Prot datë 25.08.2023). Raporti teknik i datës 31.07.2023 nga AKCESK ka identifikuar qartë nevojën për të ndërmarrë masa korrigjuese të menjëhershme në lidhje me të gjitha pajisjet dhe sistemet që janë në fazën e fundit të jetës së tyre të përdorimit (EOL) ose që janë në prag të mbarimit të suportit nga prodhuesi dhe si pasojë mund të çënojnë operimin normal dhe sigurinë e informacionit. Në të njëjta konkluzione ka arritur dhe Audit i Brendshëm në Ministrinë e Brendshme nëpërmjet Raportit Përfundimtar të Auditimit dërguar më shkresën nr.prot. 10550/13, dt. 14/01/2025.

Identitek si institucion me infrastrukturë kritike mund të jetë subjekt i sulmeve të avancuara me rrezikshmëri të lartë. Kjo situatë është një sfidë që kërkon një përgjigje të menjëhershme. Është e qartë se nevoja për investime në sisteme dhe infrastrukturë është e rëndësishme së veçantë dhe është e nevojshme të zhvillojmë një analizë dhe plan të qartë investimi.

Me teknologjinë aktuale shoqëria ka varësi nga një furnitor i vetëm për furnizimin me dokumenta boshe. Varësia ndaj një furnitori është një aspekt shumë kritik në menaxhimin e biznesit. Varësia nga një furnitor sjell që ata të kenë fuqinë për të vendosur çmimet dhe kushtet, duke e bërë

Shoqërinë më të ekspozuar ndaj ndryshimeve të papritura në kosto. Nëse nuk kemi opsione të tjera për furnitorë, kemi më pak mundësi për të negociuar dhe mbrojtur interesat ekonomike të shoqërisë.

Me këto investime Shoqëria synon të identifikojë, zhvillojë dhe zbatojë inovacione dhe përmirësime të proceseve në të gjithë zinxhirin e prodhimit, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe uljes së kostove.

Ky plan përmban disa pika kyçe të investimit dhe buxhetimit:

- Infrastruktura qendrore – Rinovimi i të gjitha pajisjeve harduerike bazë të sistemit (Server, Rrjeti, Pajisjet e Sigurisë,)
- Infrastruktura periferike - Rinovimi i të gjithë harduerve (PC dhe pajisjet në qendrat e aplikimit).
- Struktura e personalizimit – Rinovoni i komponentëve kritikë të personalizimit makina (module laser). Rinovimi i infrastrukturës ICAO PKI. Implementimi i një gjenerate të re e softuerit të Personalizimit, implementimi i vulës dixhitale
- Dokumentat biometrikë boshe – Prezantimi i një dizajni të ri dokumenti me të rinovuar dhe grup i veçorive të sigurisë. Përmirësimi i çipit në gjeneratën e fundit, sigurimi i pajtueshmërisë me standardet e ICAO.
- Investim në rritjen e kapaciteteve në burime njerëzore për të mbështetur transformimin dixhital që shoqëria ka si objektiv

Priotitetet e tjera kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut, menaxhimi i mosfunksionalitetit dhe mospërdorueshmërisë së pajisjeve dhe softuerëve (Manage Hardware and Software Obsolescence), përditësimi i sistemeve për të garantuar mbrojtjen e sigurisë dhe disponueshmërisë së informacionit ndaj sulmeve të brendshme dhe të jashtme dhe certifikimin ISO 27001, ngritja e një Ambienti të Vijueshmërisë së shërbimit (Disaster Recovery Site), implementimi i Zero Trust infrastructure si dhe përmbushja e praktikave më të mira të ICAO për lëshimin e dokumenteve të identitetit.

Menaxhimi i mosfunksionalitetit dhe mospërdorueshmërisë së pajisjeve dhe softuerëve (Manage Hardware and Software obsolescence) është një proces i cili konsiston në planifikimin, identifikimin, ndërhyrjen dhe menaxhimin e pajisjeve dhe softuerëve të cilët kanë përfunduar ciklin e mbështetjes ose janë në prag të përfundimit të tij nga prodhuesi. Kjo praktikë është e rëndësishme për të siguruar që infrastruktura teknologjike e Shoqërisë është efikase dhe e sigurt, dhe për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e Shoqërisë në mënyrë të qëndrueshme. Përfshihet ristrukturimi i rrjetit, investimin në teknologjitë e fundit dhe monitorimin e vazhdueshëm të performancës së tyre. Praktika ndihmon në parandalimin e ndërprerjes së papritur të operacioneve dhe përmirëson sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve. Si dhe është raportuar situata është kritike në këtë fushë dhe kërkohet ndërhyrje e menjehershme.

Garantimi i mbrojtjes së sigurisë së informacionit ndaj sulmeve të brendshme dhe të jashtme (Maintain IT Security Protection Against Internal/External Attacks) është një proces i përdorur për të siguruar që informacioni dhe sistemet e Shoqërisë të mbrohen nga kërcënime të brendshme dhe të jashtme. Ky proces përfshin implementimin dhe zbatimin e masave të sigurisë për të

parandaluar, zbuluar dhe trajtuar rreziqet e sigurisë që mund të vijnë nga brenda organizatës (sulme të brendshme) dhe vecanërisht nga jashtë saj (sulme të jashtme). Rritja e nivelit të sigurisë së informacionit është një përgjegjësi e rëndësishme në një kohë kur kërcënimet e sigurisë janë të pranishme dhe ndryshojnë vazhdimisht.

Certifikimin ISO 27001 dhe përmbushja e praktikave më të mira të ICAO për lëshimin e dokumenteve të identitetit" përfshin dy aspekte të rëndësishëm në fushën e sigurisë së informacionit dhe lëshimit të dokumenteve të identitetit:

Certifikimi ISO 27001: 2022 është një standard ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard ofron një qasje sistematike për menaxhimin e informacionit të ndjeshëm të një organizate, duke siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe dispozicionin e tij. Për të mbajtur certifikimin ISO 27001 do të thotë që një Shoqëri duhet të plotësojë vazhdimisht kërkesat e këtij standardi, duke përfshirë implementimin dhe mbajtjen e politikave, procedurave dhe kontrolleve të forta të sigurisë së informacionit. Ky certifikim demonstroi një përkushtim për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm, siç janë të dhënat personale dhe të dhënat e biznesit të konfidencialshme, nga kërcënime dhe vulnerabilitete të ndryshme. Për të njëjtat arsye është e domosdoshme vijimi i mbajtjes së këtij standardi për periudhën në vazhdim.

Standarti ISO/EIC 7810 Praktikë më të mira të ICAO për lëshimin e dokumenteve të identitetit: Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO) cakton standarde globale për dokumentet e udhëtimit, përfshirë pasaportat. Për të përmbushur praktikën më të mira të ICAO është jetësore për qeveritë dhe shoqëritë që janë përfshirë në lëshimin e pasaportave. Këto praktika mbulojnë aspekte të ndryshme të dizajnit të pasaportës, tipareve të sigurisë, proceseve të lëshimit dhe mbrojtjes së të dhënave. Përmbajtja e standardeve të ICAO siguron që pasaportat dhe dokumentet e tjera të identitetit janë të sigurta, të vështira për tu falsifikuar dhe të njohura në mbarë botën. Kjo ndihmon në përmirësimin e sigurisë dhe parandalimin e krimit të pasaportave dhe vjedhjes së identitetit.

Projekti "Identiteti Dixhital për Shtetasit Shqiptarë" është një nismë kyçe brenda Strategjisë Ndërsektoriale "Axhenda Dixhitale e Shqipërisë dhe Plani i Veprimit 2022-2026", e miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 370, datë 1.6.2022. Ky projekt synon të harmonizojë zhvillimet dixhitale të Shqipërisë me Rregulloren e Parlamentit Evropian nr. 910/2014 dhe të Këshillit Evropian të datës 23 Korrik 2014 mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike (eIDAS), si dhe ndryshimet e saj nëpërmjet Rregullores së Parlamentit Evropian 2024/1183, e njohur ndryshe si eIDAS 2.0. Në këtë kontekst, projekti fokusohet në rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të identitetit dixhital për qytetarët shqiptarë.

Projekti është përfshirë në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, duke theksuar angazhimin e qeverisë për të modernizuar infrastrukturën dixhitale dhe për të përmbushur standardet ndërkombëtare për identifikimin elektronik. Implementimi i këtij projekti përshin zhvillimin e një platforme të avancuar për menaxhimin e identiteteve dixhitale, që do të ofrojë një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për transaksionet elektronike. Kjo iniciativë do të ndihmojë në fuqizimin e qasjes së qytetarëve në shërbimet publike dhe private në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt. Ky investim synon të krijojë një sistem identifikimi dixhital të standardizuar dhe të besueshëm, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimeve elektronike në Shqipëri. Me anë të

këtij projekti, Shqipëria synon të përmirësojë integrimin e saj në tregun e përbashkët evropian dhe të lehtësojë aksesin e qytetarëve dhe bizneseve në shërbime ndërkufitare. Projekti gjithashtu mbështet objektivat e dixhitalizimit të qeverisjes, duke promovuar transparencën dhe reduktimin e burokracisë.

Projekti “Identiteti Dixhital për Shtetasit Shqiptarë” përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të sistemit të identifikimit elektronik në vend. Përmes harmonizimit me rregulloret evropiane dhe implementimit të teknologjive të reja, ai synon të sigurojë një shërbim të besueshëm dhe të aksesueshëm për të gjithë qytetarët. Janë miratuar ndryshimet në ligjin për letërnjoftimet duke përfshirë krijimin e ID-së digjitale (Ligji nr. 6/2025). Kjo nismë do të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve dhe do të rrisë besimin në shërbimet dixhitale, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Gjatë vitit 2025, shoqëria ka realizuar me sukses implementimin e **shërbimit të kuponit elektronik (e-Voucher)**, një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të proceseve dhe dixhitalizimit të shërbimeve për qytetarët dhe institucionet. Në vitin 2026, fokusi zhvendoset nga implementimi fillestar drejt zgjerimit, përmirësimit dhe integritetit të mëtejshëm të këtij shërbimi, duke e përshtatur me objektivat strategjike të Qeverisë Shqiptare për të ndërtuar një ekonomi gjithnjë e më pak të varur nga paraja fizike, në kuadër të vizionit kombëtar “Shqipëria Cashless 2030”.

Vizioni shtetëror për të reduktuar ndjeshëm përdorimin e parasë cash brenda vitit 2030 ka sjellë një orientim të qartë drejt dixhitalizimit të proceseve financiare dhe administrative. Shërbimi i kuponit elektronik, tashmë i funksionalizuar, përbën një prej komponentëve kryesorë të kësaj transformimi. Ai mundëson kryerjen e transaksioneve të shpejta, të sigurta dhe plotësisht të gjurmueshme përmes kanaleve dixhitale si e-maili, aplikacionet mobile apo mesazhet SMS. Kjo jo vetëm që eliminon nevojën për kuponët fizikë, por krijon një përvojë të përmirësuar për përdoruesit dhe një model modern të administrimit.

Në fazën e dytë të zhvillimit gjatë vitit 2026, prioritet mbetet zgjerimi i përdorimit të e-Voucher-it, rritja e kapaciteteve teknike, integrimi i tij me sisteme të tjera institucionale dhe rritja e shkallës së automatizimit. Përdoruesit përfitojnë duke kursyer kohë dhe duke shmangur procedurat fizike, ndërsa institucionet reduktojnë kostot administrative, logjistike dhe të prodhimit.

Ky përmirësim sjell gjithashtu avantazhe të qarta për mjedisin, duke reduktuar përdorimin e letres dhe materialeve të tjera fizike, në përputhje me politikat e qëndrueshmërisë. Sistemi dixhital i e-Voucher ofron një nivel të lartë sigurie dhe gjurmueshmërie, duke minimizuar rreziqet e abuzimeve, falsifikimeve dhe humbjeve të kuponëve fizikë. Të dhënat e përdorimit monitorohen dhe analizohen automatikisht, duke mundësuar përmirësime të vazhdueshme, planifikim më të saktë dhe vendimmarrje strategjike.

Në tërësi, viti 2026 përfaqëson një periudhë konsolidimi dhe rritje për shërbimin e kuponit elektronik, duke e kthyer atë në një mjet të rëndësishëm në mbështetje të transformimit drejt një ekonomie moderne, të dixhitalizuar dhe në linjë me vizionin kombëtar për një Shqipëri “cashless”.

Ambientet e Vijueshmërisë të shërbimit (Disaster Recovery Site - DRS) mundëson vazhdueshmërinë e shërbimit edhe pse në mënyrë të reduktuar në raste situatash emergjente,

katastrofash natyrore, apo edhe dëmeve të qëllimshme të natyrës fizike ose kibernetike (skenari "ransomëare") përkundrejt infrastrukturës ekzistuese. Mungesa e ambienteve të tillë, do të shkaktonte një pamundësi të prodhimit të dokumentave dhe përmbushjes së detyrimeve që ka institucioni për pajisjen me dokumentin e identifikimit ose pasaportës për qytetarët shqiptar. Arkitektura kompjuterike e bazuar mbi paradigmen "Zero Trust Infrastructure" parashikon implementimin e një niveli të lartë sigurie dhe autentifikim të thelluar për përjasjen kundrejt sistemit kompjuterik të shoqërisë. Kjo arkititekturë rekomandohet për mjedise kompjuterike që kanë të dhëna sensitive dhe impakt të madh në shërbimet publike që ofrohen qytetarëve pasi bëhet fjalë për sigurinë e të dhënave të qytetarëve. Përjasja aktuale është 15 vite e vjetër dhe paraqet si e tillë një nevojë për aplikimin e standarteve dhe modeleve moderne dhe bashkohore. Ky është dhe një rekomandim i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Plani i investimit do të financihet nga fitimet e realizuar. Shoqëria për 3 vitet e para 2023-2026 nuk parashikon të shpërndaj dividend, pasi fitimet e realizuara parashikohen të investohen në zërat e përcaktuara më sipër për të siguruar vazhdueshmërinë e shërbimit.

Në vijim, paraqitet një analizë e situatës aktuale dhe ndikimet e mundshme nëse nuk kryhen investime të rëndësishme në sistemin aktual. Përveç kësaj, është paraqitur dhe investimi për përditësimin e sistemit dhe infrastrukturës.

Situata aktuale dhe ndikimet e mundshme:

Sistemi aktual për dokumentacionin biometrik përballë me sfida të ndryshme, përfshirë zhvillimet e reja teknologjike dhe ndryshimet në kërkesat ligjore sipas direktivave të BE. Nëse vazhdojmë me sistemin aktual, mund të përjetojmë ndikime si mosperformanca e sistemit, mungesa e sigurisë, dhe pamundësia për të përmbushur standardet e fundit ndërkombëtare e deri në ndalimin e plotë të prodhimit.

Investimi në Infrastrukturë dhe teknologji të re:

Parashikohet një investim në bashkëpunim me operatorë lider në treg, të cilët gëzojnë kapacitetin për të sjellë përditësime në infrastrukturë dhe teknologji.

Ky proces mund të kërkojë një periudhë të gjatë përzgjedhjeje dhe implementimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe efikas me operatorët e përzgjedhur. Paraqitja e opsioneve nga operatorët e mundshëm shërben si një bazë për një analizë të hollësishme dhe përdorimin e një metodologjie të strukturuar për të përcaktuar opsionin më të përshtatshëm dhe të avantazhuar për përditësimin e sistemit dhe infrastrukturës.

Për të siguruar një zgjedhje të përshtatshme me qëllimet dhe nevojat e shoqërisë, analiza e këtij procesi do të përfshijë një vlerësim të detajuar të kostove, avantazheve dhe rreziqeve për secilën opsion. Kjo përjasje analitike do të ofrojë një bazë solide për të marrë një vendim të përgjegjshëm dhe strategjik në lidhje me përditësimin e sistemit dhe infrastrukturës.

TREGUESIT E AKTIVITETIT TË VITIT 2025

Treguesit e paraqitur në tabelën më poshtë tregojnë rezultatin e aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2025

Përshkrimi	2025	2024
Te ardhurat	3,535,863,224	3,679,714,925
Te ardhura te tjera	321,743	-
Kosto e mallit të shitur	-949,006,200	-1,661,975,501
Fitimi bruto	2,344,561,286	2,017,739,424
Shpenzime operacionale	-916,602,903	-372,477,158
Fitimi Operacional	1,670,575,864	1,645,262,266
Shpenzime financiare	-10,837,991	-11,486,747
Fitimi para tatimit	1,639,311,704	1,633,775,519
Shpenzime tatim fitimi	-247,430,696	-247,074,216
Tatim i shtyre		1,629,271
Fitimi neto	1,391,881,007	1,388,330,574

Të ardhurat sipas produkteve:

Përshkrimi	2024	2024
Të ardhura nga pasaportat	3,093,410,595	3,324,345,717
Të ardhura kartat e identitetit	370,129,129	296,975,343
Të ardhura nga leje qëndrimi	72,323,500	55,351,750
Të tjera	321,743	3,042,115
Total të ardhura	3,536,184,967	3,679,714,925

Kosto e mallit të shitur përbën zërin kryesor të shpenzimeve të shoqërisë.

Periudha e realizmit e të ardhurave është nga 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2025. Shoqëria realizoj të ardhura në vlerën 3,536,184,967 Lekë nga shitja e dokumentave biometrike. Shoqëria administron dhe operon Sistemin për furnizimin e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike për qytetarët dhe / ose banorët e Shqipërisë. Shoqëria nuk shet mallra ose shërbime të tjera si pjesë e aktiviteteve të zakonshme të biznesit. Të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur kontrolli i mallrave ose shërbimeve transferohet tek klienti në një shumë që reflekton shumën që Shoqëria pret në këmbim të transfertës të këtyre mallrave ose shërbimeve për një klient.

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje me rastin e përdorimit të shërbimit ose kur ndodhin. Shpenzimet për garancitë njihen kur Shoqëria mbart një detyrim, i cili zakonisht ndodh kur mallrat e lidhura shiten.

Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 15% e fitimit të tatueshëm.

PËRFUNDIME

Objektivi kryesor i shoqërisë për vitin 2025 ka qenë vazhdimësia e shërbimit dhe operimi i rregullt, implementimi i Letërnjoftimit me procedurë të përshpejtuar dhe Kuponit elektronikë të cilën shoqëria e ka arritur me sukses.

Shoqëria synon të sigurojë cilësi dhe qëndrueshmëri në ofrimin e shërbimeve të saj. Ky angazhim përfshin monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të operimit dhe menaxhimit, me qëllim që të përmbushen pritshmëritë e klientëve dhe të sigurohet përputhshmëria me standardet ligjore dhe rregullatore. Në këtë mënyrë, shoqëria garanton që çdo dokument biometrik i prodhuar dhe i shpërndarë është në përputhje me kërkesat dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe cilësisë.

Në përputhje me këto angazhime, shoqëria ka arritur një nivel të lartë të kënaqësisë së qytetarëve dhe ka fituar besimin e tyre për cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve të saj. Kjo përpjekje për përmirësim të vazhdueshëm dhe përmbushje të pritshmërive të klientëve mbetet një prioritet kryesor për shoqërinë, duke siguruar që të ardhurat dhe suksesi i saj të jenë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në të ardhmen.